



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 23.12.2025
Numër Protokolli: 8043/2025

A.nr.1752/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Ardita Haxhnikaj Demi, Malsore Gashi Bajraktari dhe, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1752/2025, të datës 01.10.2025, të parashtruar nga ankuesi F.B, kundër organit të punësimit: Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1752/2025, e datës 01.10.2025, e parashtruar nga ankuesi F.B.

II.Anulohet Njoftimi me numër protokolli 1539 i datës 01.09.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare për kandidatin e suksesshëm për pozitën “Zyrtar për Teknologji Informative”, si dhe Akt Emërimi me numër protokolli 1914, i datës 02.10.2025, lidhur me kandidatin e suksesshëm për pozitën “Zyrtar për Teknologji Informative”.

III.Mbetet në fuqi, Konkursi me Nr. Reference: RN00018128 për Grupin e Teknologjisë Informative, pozita Zyrtar për Teknologji Informative, i shpallur nga Komuna e Fushë Kosovës ndërsa çështja kthehet në fazën e Themelimit të Komisionit Përzgjedhës.

IV.Obligohet Kryetari i Komunës dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Fushë Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ndërmarr të gjitha veprimet si në pikën II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, F.B (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 30.09.2025, përmes emalit zyrtar të Këshillit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila ankesë është pranuar në Këshill me datë 01.10.2025, kundër konkursit me Reference: RN00018128 për Grupin e Teknologjisë Informative, pozita Zyrtar për Teknologji Informative, i shpallur nga Komuna e Fushë Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.10.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 21.10.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 6475/2025 të datës 01.10.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi me numër protokolli 1539, i datës 01.09.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtarë të kandidatit të suksesshëm; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; emali i datës 30.09.2025, dërguar nga ankuesi tek Këshilli; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 09.10.2025, dërguar nga R.K, për V.K; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1752/2025, të datës 21.10.2025; Kërkesë për shpalljen e konkursit e datës 02.07.2025; Konkursi me numër referencë RN00018128, i datës 02.07.2025; Lista e Apliakntëve; Verifikimi paraprak i datës 14.08.2025; Vendimi me numër protokolli 1478, i datës 19.08.2025, për formimin e Komisionit të Pranimi i nxjerr nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës; Akt Emërimi i datës 14.08.2025,për E.Q; Akt Emërimi i datës 14.08.2025,për A.G; Akt Emërimi i datës 01.06.2011,për S.V; Akt Emërimi i datës 20.04.2013,për S.R; Akt Emërimi i datës 21.09.2022,për V.K; Testi me shkrim për Z.P; Testi me shkrim i ankuesit; Njoftimi i datës 26.08.2025, i nxjerr nga Menaxherja e Personelit e Komunës së Fushë Kosovës; emali i datës 26.08.2025; Renditja përfundimtare e kandidateve të suksesshëm; Pyetjet e parrafshuar në intervistë me gojë; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin F.B, nga anëtari i komisionit E.Q; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin F.B, nga anëtari i komisionit A.G; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin F.B, nga anëtari i komisionit V.S; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin F.B, nga anëtari i komisionit S.B; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin Z.P, nga anëtari i komisionit E.Q;

Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin Z.P, nga anëtari i komisionit A.G; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin Z.P, nga anëtari i komisionit V.S; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin Z.P, nga anëtari i komisionit S.M; Formuari për Vlerësimin Individual të Anëtarit të

Komisionit për kandidatin në intervistë i datës 29.08.2025, për kandidatin Z.P, nga anëtari i komisionit V.K; Aplikacioni i Z.P, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 65/45-54, e datës 18.01.2022, për Z.P, e lëshuar nga kolegji UBT; Certifikatat e ankuesit; Vërtetim i datës 17.08.2018; Dëshmi punës pa datë; Vërtetim i datës 16.07.2025; Vendim i datës 18.12.2024; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Vendimi i datës 07.06.2024; Pasqyra e trustit për Z.P, për periudhën nga data 17.08.2017, deri me datën 29.09.2025; Aplikacioni i F.B, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 488/12, e datës 11.10.2012, për F.B, e lëshuar nga Kolegji AAB; Diplomë me numër protokolli 196/02/8-18, e datës 10.04.2018, për F.B, e lëshuar nga Kolegji Riinvest; Certifikatat për ankuesin; Dëshmi e punës e datës 02.09.2024; Akt Emërimi i datës 03.10.2024; Pasqyra e trustit për F.B, për periudhën nga data 29.09.2010, deri me datën 10.04.2025; Emali i datës 08.12.2024, dërguar nga V.K, për R.K; Emali i datës 18.12.2025, dërguar nga V.K, për R.K; Akt Emërimi me numër protokolli 1914, i datës 02.10.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se Komuna e Fushë Kosovës, më datë 02.07.2025, ka shpall konkursin me Reference: RN00018128, për Grupin e Teknologjisë Informative, pozita “Zyrtar për Teknologji Informative”, Profesional 2, numri i kërkuar një (1) pozitë i hapur për aplikim nga data 03.07.2025 deri më datën 01.08.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsej 27 kandidatë, ku prej tyre 6 kandidatë, janë përfshirë në listën e ngushtë.

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i Komunës së Fushë Kosovës më datë 01.09.2025 ka shpallur listën përfundimtare të vlerësimit ku sipas saj rezulton se si kandidat fitues me më së shumti pikë është Z.P, me gjithsej 97 pikë, ndërsa ankuesi është vlerësuar me gjithsej 70.6, pikë dhe është renditur i dyti në listë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se janë bërë shkelje në këtë procedurë dhe parregullsi gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit mungese të transparencës në publikimin e rezultateve dyshime mbi paanshmërinë e komisionit mungesë profesionalizimi gjatë intervistës.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të RN00018128, për Grupin e Teknologjisë Informative”, për pozitën ”Zyrtar për Teknologji Informative, numri i kërkuar një (1) pozitë, Profesional 2, dhe konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) Fakulteti i Shkencave Kompjuterike Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike Informatikë Inxhinireike, Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimit, Informatikë dhe Teknologji Informative, Inxhinieri Elektroteknike Kompjuterike dhe Telekomunikacion.

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Sipas shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, konstaton se Komuna e Fushë Kosovës, më datë 01.09.2025 ka shpallur njoftimin përfundimtar ku sipas njoftimit rezulton se si kandidat fitues me më së shumti pikë është Zgjim Prebreza, me gjithsej 97 pikë, ndërsa Akt emërimit kandidatit të përzgjedhur i’a ka lëshuar me datë 02.10.2025 ndërsa ankuesi F.B me datë 30.09.2025 ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, prandaj mbi bazën e kësaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komuna e Fushë Kosovës, duke lëshuar akt emërimit pa përfunduar procedurat e ankimimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, konkretisht me nenin 130, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet: *1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën*, andaj me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, Kolegji ka anuluar akt emërimit sikur në dispozitiv të këtij vendimi. e në rastin konkret Kolegji i Këshilli konstaton se Komuna e Fushë Kosovës njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare e ka bërë në kohën kur nga ankuesi F.B, e ka parashtrua ankesë në Këshill e që është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse në rast të parashtrimit të ankesës nga ndonjë kandidat për pranim në shërbimin civil, organi i punësimit është e obliguar që të pezullojë çdo veprime deri në zgjedhjen e ankesës nga organi kompetent, gjegjësit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të kësaj çështje ka gjetur se Komisioni i Pranimit, i themeluar sipas vendimit me numër protokolli 1478, të datës 19.08.2025, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, përgjegjës për vlerësimin profesional të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit, ka qenë komisioni në këtë përbërje: z. E.Q, Kryesuesi i Komisionit, i cili sipas Akt emërimit të datës 14.08.2025 , mbanë pozitën e punës “Shef i Sektorit”, znj. A.G, e cila sipas Akt emërimit të datës 14.08.2025 , mbanë pozitën e punës “ Udhëheqëse e Sektorit për Gjeodezi”, znj. S.V, e cila sipas Akt emërimit të datës 01.06.2011, mbanë pozitën e punës “Inspektor Financiar”, z, S.R, i cili sipas Akt emërimit të datës 20.04.2025 , mbanë pozitën e punës “ Zyrtar i Teknologjisë Informative”, znj. V.K, e cila sipas Akt emërimit të datës 21.09.2022, mbanë pozitën e punës “Zyrtare e Lartë e Personelit. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se komisioni i pranimit, nuk ka qenë në përputhje me nenin 40, paragrafi 1,2, nën paragrafi 2.1,2.2,2.3

Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku thuhet se: 1. *Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit.* 2. *Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, si dhe nenit 20, paragrafi 1, 2, nen paragrafi 2.1,1.2 dhe 2.3 të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimin në Shërbimin Civil.* Prandaj Kolegji si rrethanë faktike dhe juridike për rikthimin e çështjes në fazën e themelimit të Komisionit duke marrë për bazë dispozitat e lartshënuar, konstatoj se me qëllim të rikthimit të ligjshmërisë në këtë procedurë të rekrutimit duhet që nga Komuna e Fushës Kosovës të themelohet Komisioni në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, sepse një komision i pa ligjshëm si rrjedhojë, ka shkaktuar pa ligjshmëri gjata zhvillimit të procedurës së rekrutimit.

Thënë me tepër, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritore iu referua nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: Procedura e pranimit në Shërbimin Civil 1. *Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.* 2. *Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së.* 3. *Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse.* 4. *Përfshirja në përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni.* 5. *Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.* 6. *Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit.* 7. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.* 8. *Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë.* 10. *Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë.* 11. *Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.*

Andaj, bazuar në faktet e lartë përmendura më lartë, Kolegji i Këshillit, konstatohet se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Fushë Kosovës me rastin e nxjerrjes së Njoftimit numër protokoli 1539 të datës 01.09.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare për pozitën “Zyrtar për Teknologji Informativ”, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht ligjin material duke vepruar kështu në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës’

Kështu që, thënë si me sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1752/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit F.B;
- Kryetari të Komunës së Fushë Kosovës
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Fushë Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.